



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.327/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, dega në Klinë, për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 23.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHET si e bazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, me shenjen ZL.Anr.327/2017 e datës 22.10.2017, kështu që Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Klinë, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 200.00 (dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

PZAP-i më datë 22.10.2017, ka pranuar një ankesë nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS) në të cilën ka theksuar se kandidatja e AAK-së Lumnije Pantina në profilin e saj në facebook, më datë 21.10.2017, rreth orës 16:14 minuta ka pranuar e ka konfirmuar postimin e personit me emrin Merita Miki Pantina, e cila postim e ka në përmbajtje fotografinë e kandidates Lumnije Pantina, logon dhe numërin e partisë si dhe fotografinë e kandidatit për kryetar të Komunes së Klinës, Zenun Elezaj nga radhët e subjektit politik AAK.

Më tej ka theksuar se ky veprim është në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1 pika b) e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Në mbështetje të pretendimeve ka bashkangjitur një fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Subjekti politik AAK në përgjigjen në ankesë të datës 23.10.2017, ka theksuar se postimi nuk është bërë nga kandidatja e subjektit politik AAK Lumije Pantina, por është bërë nga një person tjetër. Gjithashtu, ka theksuar se AAK ka ndërmarr veprime që janë të parapar me nenin 3.3, 3.4 dhe 3.6 për thirrjen dhe lajmrimin e të gjitha strukturave dhe mbështetësve që ta respektojnë ligjin në fuqi dhe Rregulloren e Kodit të Mirësjelljes.

Përgjigjes në ankesë i ka bashkangjitur 3 fotografi dhe thirrjen publike të datës 20.10.2017, të bërë nga subjekti politik AAK.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal nga radhët e subjektit politik AAK, Lumnije Pantina në profilin e saj në facebook, ka konfirmuar një postim nga Merita Miki Pantina në ditën e heshtjes zgjedhore konkretisht me datë 21.10.2017 rreth ores 16:14 minuta, i cili postim ka në përmbajtje fotografinë e kandidates Lumnije Pantina, logon dhe numërin e subjektit politik AAK, si dhe fotografinë e kandidatit për kryetar të Komunes së Klinës, Zenun Elezaj veprime këto që janë në kundërshtim dhe me nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së e cila përcakton se: *“Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*.

Pretendimet e subjektit politik AAK se postimi nuk është bërë nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Prishtinë Lumije Pantina, por nga një person tjetër këto pretendime nuk patën ndikim në meritat e lëndës pasi që kanë qenë të pa argumentuara në fakte, ndërkaq me nenin 32.5 të LZP-së përcakton se: Subjektet politike mbahen përgjegjës për shkeljet e këtij Kodi të kryera nga anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët.

Andaj, PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik Aleanca për Ardhmërin e Kosovës (AAK), është përgjegjëse për veprimet e saja pasi që ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku parashihet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja fushatë në çfarëdo mënyre.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.327/2017 më datën 23.10.2017

Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.